DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No 0204-278/5
-VI-
Data Datum Date 13.03.2014

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 05.03.2014
Nr. 0204-278

**PËR:** **Begzad Sinani,** Kryetar i Komunës së Kamenicës
**Bajram Dërmaku,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës

**LËNDA: KONFIRMIMI I LIGJSHMERISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË Kamenicës Nr. 01-7152,** të pranuar më datën 05.03.2014

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të vendimit Nr. 01-7152 të miratuar me datën 28.02.2014 nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik është si në vijim:

- Vendimi me Nr. 01-7152, mbi shfuqizimin e vendimit Nr. 01- 01481 për zgjedhjen e zëvendëskryesueses së kuvendit për komunitete.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**
**Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së**

**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL*
*Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së*
*Arkivit të MAPL-së*

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. / Br. / No. 0204-278/5
Data / Datum / Date 13.05.2014

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Dana: 05.03.2014
Br. 0204-278

**Za:** **Begzad Sinani,** Gradonačelnik Opštine Kamenica
**Bajram Dermaku,** Predsesdvajući Skupštine Opštine Kamenica

**PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE SKUPŠTINE OPŠTINE KAMENICA , br. 01-7152,** primljena dana 05.03.2014

Poštovani,

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonom br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu, kao i Uredbom Br. 02/2011, Poljima Administrativne Odgovornosti kabineta Premijera i Ministrstva, dodatak XII, posla razmatranja odluke br. 01-7152 usvojene dana 28.02.2014 od Skupštine Opštine Kamenica, POTVRDJUJE zakonitost akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravni Akt niže naveden ima punu pravnu snagu :

- Odluka Br. 01-7152 o ukidanju odluke br.01-01481 za izbor zamenikapredsedavjućeg skupštine za zajednice

S poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**
**Zamenik Premijera i Ministar MALS-a**

**Kopija:** *Besnik Osmani,Generalni Sekretar MALS-a*
*Rukovodiocima Uprava MALS-a*
*Arhivu MALS-a*

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. Br. 01 Nr. Br. 7152
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 4/03 2014
KAMENICË

KOMUNA E KAMENICËS
KUVENDI I KOMUNËS
01.Nr. _______, Më 03.03.2014

Në bazë të dispozitave të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15, Qershor 2008") dhe nenit dhe 54 të Statutit të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **28.02.2014** mori

**VENDIM**
**MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 01-01481 PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËS KRYESUESES SË KUVENDIT PER KOMUNITETE**

I

**Shfuqizohet** Vendimi nr.01-01481 për zgjedhjen e zëvendës kryesueses së kuvendit të komunës për komunitete z. Dijana Nikoliq.

II

Kuvendi i Komunës më 10.01.2014 ka miratuar Vendimin për zgjedhjene z. Dijana Nikoliq zëvendës kryesuese e kuvendit të komunës për komunitete.

III

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit me nr.01-01481, të datës 10.01.2014, të Kuvendit të Komunës së Kamenicës, ka konstatuar se:

- Vendimi nr.01-01481 për për zgjedhjen e zëvendës-kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete në Komunën e Kamenicës, është në kundërshtim me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, përkatësisht nenin 54.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, i cili e përcakton qartë se në komunat ku së paku 10 % e qytetarëve i takojnë komuniteteve jo shumicë, posti i zëvendës kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete rezervohet për përfaqësuesit e këtyre komuniteteve.
- Bazuar në regjistrimin e popullsisë 2011 dhe vlerësimin popullsisë të vitit 2012 të bërë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komuna e Kamenicës ka më pak se 10 % të komuniteteve jo- shumicë.

MAPL ka kërkuar që në afat prej 30 ditësh të bëhet rishqyrtimi i Vendimit nr.01-01481, të Kuvendit të Komunës së Kamenicës.

IV

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2014 e ka shqyrtuar Kërkesën për rishqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit të Komunës së Kamenicës, Nr.01-01481 dhe ka vendosur si në pikën I të këtij Vendimi.

V

Me Vendimin të njoftohen: Kryetari, Kryesuesi, Dijana Nikoliq, Zyra Ligjore, Shërbimi Profesional i Kuvendit dhe Qendra për Shërbime të Qytetarëve.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

_______________

**Bajram Dërmaku**

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – KOMUNA KAMENICË